L I G J
Nr.8006, datë 5.10.1995

PËR MIRATIMIN E FORMULËS SË MBAJTËSVE TË AKSIONEVE NË MOMENTIN E SHITJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE QË VEPROJNË NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Formula e mbajtësve të aksioneve në momentin e shitjes së aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike është si vijon:

- Jo më pak se 30 për qind të aksioneve një investitori strategjik.
- Jo më pak se 30 për qind të aksioneve sipas një plani të privatizimit masiv.

Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike vendos rast pas rasti brenda kufijve të mësipërm.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1260, datë 30.10.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha